

V E N D I M
Nr. 23, datë 28.1.2002

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.564, DATË 13.10.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSAT E KONVIKTEVE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E FAMILJEVE TË NXËNËSVE DHE STUDENTËVE DHE FËMIJËT QË PRANOHEN NË SHTËPITË E FËMIJËS, NË INSTITUTIN E FËMIJËVE QË NUK DËGJOJNË DHE NUK SHIKOJNË DHE NË INSTITUTIN E FËMIJËVE ME PRAPAMBETJE TË LEHTË MENDORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002”, të shkronjës “c” të nenit 32 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.564, datë 13.10.2001 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 1 të ndryshohet si më poshtë vijon:

“Nxënësve dhe studentëve u jepet bursë ose gjysmëbursë çdo vit. Këto fonde të përballohen nga Buxheti i Shtetit, përkatësisht për nxënësit, nga granti i miratuar për pushtetin vendor dhe për studentët, nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.”.

2. Pas pikës 12 të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për vitin akademik 2001-2002, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës t’i shtohen 100 bursa për arsimin e lartë, të cilat përballohen nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.”.

3. Pas pikës 14 të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave shtesë të jetë data 1 mars 2002.”.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta